

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Behar Ymeri, me sekretaren juridike Igballe Azemi, në lëndën penale kundër të akuzuarit **N. K.**, nga Gj., për shkak të veprës penale, lidhja e paautorizuar në shërbime nga neni 321 të KPRK-s, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan - Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.85/2016, të datës 25.01.2016 të cilën e përfaqësonte Prokurorja Esat Ademi, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe publik, më datën 25.12.2016, mori dhe publikisht shpalli këtë,

A K T G J Y K I M

I pandehuri **N. K.**, nga i ati M., e ëma N., e lindur P., i lindur ... në Gj., Lagja "...", nr.... ndërsa jeton në fsh. M. i U., K. N., me numër telefoni ..., ka të kryer shkollën ..., ... në N., i martuar-baba i ... fëmijëve, i gjendjes ekonomike të mesme, shqiptar, shtetas i R. Kosovës, më parë i pa dënuar dhe nuk udhëhiqet procedurë për vepër tjetër penale.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse me datë2015, në shtëpinë e tij, i pandehuri N. K. nga Gj., rr... si shfrytëzues i energjisë elektrike, pa lejen e KEDS është rikyqur ilegalisht dhe ka shfrytëzuar energjinë elektrike pa lejen apo autorizimin të KEDS-it, edhe pse me parë me datën 19.11.2015 ka qene i shkyqur në shtyllën elektrike për shkak të borxhit nga persona te autorizuar te KEDS Distrikti në Gjilan.

Me çka ka kryer veprën penale lidhje e pa autorizuar ne shërbime nga neni 321 KPRK-s.

Andaj, gjykata në bazë dispozitës së lartcekur ligjore dhe neneve 4, 41, 50, 51, 73 dhe 75 të KP, si dhe nenit 365 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), të akuzuarin:

E G J Y K O N

Të akuzuarit N. K., i caktohet dënimi kumulativ me gjobë në shumë prej 300 (treqindë) euro, dhe denim me burg në kohëzgjatje prej 90 (nëntëdhjetë) ditë, të cilat dënime nuk do të ekzekutohen, nëse i akuzuari në periudhën verifikuese prej 1 (një) viti, duke filluar nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nuk kryen vepër tjetër penale.

Obligohet i akuzuari të paguaj shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të Gjykatës si dhe paushallin gjyqësor në shumë prej 30 (tridhjetë) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcnim të përmbartimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën e lartcekur ndaj të akuzuarit N. K., nga Gj., për shkak të veprës penale lidhja e paautorizuar në shërbime nga neni 321 të KPRK-s.

Në shqyrtimin gjyqësorë dhe publik, të mbajtur më datën 25.01.2017 Prokurori i shtetit Esat Ademi, gjatë fjalës përfundimtare deklaroi: edhe pas seancës së sotme të shqyrtimit gjyqësor duke u nisur nga fakti se tani i akuzuari ka pranuar veprën penale e cila i vihet në barrë sipas kësaj aktakuze edhe përkundër njoftimit nga ana e gjykatës për pasojat dhe benifitet e pranimi të fajësisë dhe faktin se ky

pranim i fajësisë është i mbështetur edhe në provat e tjera materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës, fakte që këto argumentojnë se tani i akuzuari ka kryer në tërësi veprën penale në tërësi si në

dispozitiv të kësaj aktakuze, për çka qëndroj pranë aktit akuzues dhe propozimet e cila e njëjta përmbanë dhe kërkoj nga gjykata ta shpallë fajtorë dhe ta dënonte me dënim meritore sipas ligjit.

Përkitazi me lartësinë dhe llojin e dënimit i propozoj gjykatës ti merr parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese me qëllim që dënimi të jete proporcional me shkallën e përgjegjësisë dhe rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale, ndërsa si rrethane lehtësuese të merren parasysh pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit, sjellja e mirë në gjykatore etj.

Përfaqësuesi i të dëmtuarës D. R. në fjalën përfundimtare deklaroi: e mbështesë në tërësi fjalën e prokurorit të shtetit, i bashkohem ndjekjes penale ndaj të akuzuarit ndërsa nuk paraqes kërkesë pasurore-juridike.

I pandehuri N. K., deklaron: e ndijë veten fajtor, pendohem thellë për këtë veprë, më herët nuk kam kryer vepra tjera penale, dhe i premtoj gjykatës se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra tjera penale dhe e lus gjykatën që të ma shqiptoj një dënim sa më të butë.

Në fillim të shqyrtimit gjyqësor pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit, i akuzuari N. K. ka deklaruar e pranojë fajësinë për kryerjen e veprës penale e cila më vihet në barrë sipas kësaj aktakuze.

Gjyqtari i vetëm gjykues, pas dëgjimit të prokurorit përfaqësuesit të dëmtuarës, konstatoi se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore, nga neni 248 paragrafi 1 të KPP për pranimin e fajësisë, ngase i akuzuari e kupton natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit; se pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari; se pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, si dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike nga neni 253 të KPP.

Andaj, duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, gjykata e vërtetoi këtë gjendje faktike:

Se i akuzuari N. K. ka kryer veprën penale, lidhja e paaautorizuar në shërbime nga neni 321 të KPRK-s, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata e shpalli fajtor të akuzuarin N. K., për shkak të kryerjes së veprës penale të vazhduar, lidhja e paaautorizuar në shërbime nga neni 321 të KPRK-s, ngase veprimet e të njëjtit i përmbajnë të gjitha tiparet e kësaj vepre penale dhe se për të njëjtën është edhe përgjegjës penalisht.

Me rastin e matjes së dënimit ndaj të akuzuarit N. K., gjykata i ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit sipas nenit 73 të KPRK, ku si rrethana lehtësuese, gjykata e ka marrë për bazë faktin se i akuzuari e ka pranuar fajësinë; sjelljen korrekte në gjykatë, se është penduar për kryerjen e kësaj vepre penale, më parë nuk ka kryer vepra penale dhe i ka premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të kryej vepra tjera penale, ndërsa rrethana rënduese dashjen për kryerjen e veprës penale, rrezikshmërinë shoqërore të kësaj vepre penale.

Sipas bindjes së kësaj gjykate, caktimi i dënimit me kusht, ndaj të akuzuarit N. K., është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të akuzuarit, si dhe me këtë dënim do të mund të arrihet qëllimi i dënimit, nga neni 41 të KP, i cili konsiston në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij.

Në kuptim të nenit 368 të KPP palët janë udhëzuar për të drejtën në ankesë, duke u paralajmëruar me rëndësinë e dënimit me kusht dhe kushtet të cilat duhet plotësuar që dënimi me kusht mos të revokohet duke u shëndrruar në dënim efektiv.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, si dhe paushallin gjyqësor është marrë në bazë të nenit 453 paragrafi 1 të KPP-s. Për arsyet e lartcekura u vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN,

Departamenti i Përgjithshëm

P.nr. 162/2016, Më 25.01.2017

Sekretarja juridike,
Igballe Azemi d.v

Gjyqtari
Behar Ymeri d.v

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate Themelore.